

MINORITETI MAQEDON

Të dhëna paraprake (Background)

Shqipëria ka ratifikuar Konventën-kuadër mbi minoritetet kombëtare në vitin 1999. Problemi ka qenë objekt i vëmendjes shtetërore qysh në fillimet e proceseve demokratike në Shqipëri. Në vitin 1993 u miratua Ligji Kushtetues mbi të drejtat dhe liritë e shtetasve, në të cilin sanksionoheshin edhe të drejtat e minoriteteve në territorin e Shqipërisë. Në vitin 1998 u miratua Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 20 të Kushtetutës i kushtohet një nen i veçantë çështjes së pakicave. Neni 20 përbëhet nga dy paragrafe me këtë përmbajtje: “1) Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit, të drejtat dhe liritë e tyre; 2) Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre”.

Mund të thuhet se Shteti Shqiptar i është përmbajtur vazhdimisht detyrimit që ka marrë që pas Luftës së Irë përpara Lidhjes së Kombeve për respektimin e të drejtave të minoriteteve në çastin e pranimit të tij në këtë organizatë në vitin 1920. Për pasojë, popullsitë minoritare në Shqipëri nuk kanë qenë asnjëherë objekt diskriminimi të veçantë në çdo periudhë historike të zhvillimit të Shtetit Shqiptar. Padyshim nën regjimin totalitar minoritetet kanë pësuar kufizimet e kohës, por në çdo rast ato kanë ndarë fatin e shumicës së popullsisë që ka vuajtur nga politika represive brenda dhe nga izolimi i plotë me jashtë. Kuptohet se pozita e minoriteteve dhe trajtimi i tyre ka marrë një dimension të ri me rënien e regjimit totalitar dhe më zhvillimin e proceseve demokratike në Shqipëri. Pozita e minoriteteve është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme jo vetëm në kuadrin e të drejtave dhe lirive të shtetasve, por edhe në drejtim të hapësirave të reja që janë krijuar në marrëdhëniet me shtetet amë.

Angazhimi ndërkombëtar i Shqipërisë në fushën e minoriteteve është ripohuar edhe me ratifikimin në vitin 1999 të Konventës-kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve.

Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se nuk ka patur probleme dhe se janë arritur të gjitha standartet e kërkuara si nga legjislacioni i brendshëm ashtu edhe nga ai ndërkombëtar. Vendi ka afro 12 vjet që ka hyrë në rrugën e transformimeve demokratike dhe gjatë kësaj periudhe janë bërë shumë reforma dhe janë arritur rezultate të ndjeshme që ia kanë ndryshuar pamjen shoqërisë shqiptare. Megjithatë, periudha e tranzicionit në Shqipëri ka qenë relativisht e vështirë dhe kjo ka ndikuar negativisht dhe ka nxjerrë

pengesa në ushtrimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore si nga shumica e popullsisë, ashtu edhe nga popullsitë minoritare.

Minoriteti maqedon ndodhet i përqëndruar në zonën e Prespës që shtrihet në verilindje të qytetit të Korçës, 30 km larg tij. Kjo zonë është e vendosur në skajin juglindor të territorit shqiptar në kufi me Maqedoninë dhe Greqinë. Sipërfaqja e zonës së Prespës është 213.9 km². Popullsia aktualisht përbëhet nga 418 banorë. Vija përgjatë liqenit të Prespës me kufirin shqiptar është 35 km. Gjatë kësaj vije shtrihen të 9 fshatrat minoritare të zonës së Prespës që janë: Liqenasi (Pustec), Lajthiza, Zaroshka, Cerja, Shulini, Gollombopi, Gorica e Vogël, Bezmishti dhe Gorica e Madhe. Nga pikëpamja administrative, të 9 fshatrat minoritare përbëjnë një komunë me emrin Komuna e Liqenasit sipas emrit të fshatit Liqenas që është më i madhi. Ky fshat e ka patur emrin Pustec, por më vonë emri i tij dhe emrat e fshatrave të tjerë janë shqipëruar. Në takim me banorët vendas, u kërkua që fshatrat të quhen me emrat e tyre në origjinal: Pustec, Gollomboq, Bezmosht, etj. Drejtuesit e qeverisjes vendore u shprehën të gatshëm për ta pranuar këtë kërkesë.

Shteti shqiptar pati marrë angazhim për respektimin e minoriteteve që pas Luftës I Botërore kur Shqipëria u pranua si anëtare e Lidhjes së Kombeve. Por çështja minoritare në Shqipëri ka qenë identifikuar me minoritetin grek në skajin jugor të vendit në periudhën midis dy luftërave. Popullsia maqedonase e zonës së Prespës nuk ka patur statusin e minoritetit. Statusi i minoritetit iu njoh asaj pas Luftës II Botërore pas krijimit të Republikës së Maqedonisë si anëtare e Federatës Jugosllave. Gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist ai është trajtuar pak a shumë si minoriteti grek. Por kuptohet se pas ndryshimeve demokratike në Shqipëri të viteve të viteve '90, respektimi i të drejtave të minoriteteve ka marrë një dimension të ri. Pozita e minoriteteve është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme në disa drejtime, si në drejtim të gëzimit të të drejtave dhe lirive themelore me shtetasit e tjerë ashtu edhe të lidhjeve me shtetet amë.

Angazhimi i KSHH

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e ka patur si një ndër detyrat kryesore vëzhgimin e situatës në zonat minoritare. Një vëmendje i është kushtuar edhe situatës së minoritetit maqedon. Janë bërë disa herë vëzhgime. Përpara këtij vëzhgimi të fundit është kryer edhe një vëzhgim në zonën e Prespës.

Në vazhdim të angazhimit të tij, KSHH ndërmori një vëzhgim të ri në projektin që iu besua nga Këshilli i Evropës. Në këtë vëzhgim morën pjesë: Znj. Vasilika Hysi, Drejtore Ekzekutive, Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Znj. Edlira Papavangjeli,

Koordinatorë Proqramesh, Znj. Ketj Qirinxhi, Korrespondente e KSHH për rrethin e Korçës. Si rezultat i këtij vëzhgimi, u arrit në konkluzionin se situata në zonën e minoritetit maqedon paraqitet në përgjithësi kënaqshme. Të drejtat themelore respektohen dhe banorët trajtohen si shtetas të barabartë. Pozita e minoriteteve përcaktohet edhe në rrugë ligjore, veçanërisht në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 20 i Kushtetutës garanton 1) barazinë e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare përpara ligjit dhe 2) të drejtat themelore të tyre si lirinë e shprehjes së përkatësisë etnike, kulturore, fetare e gjuhësore, si dhe arsimin në gjuhën amtare. Ky angazhim i shtetit shqiptar është përforcuar aq më tepër me ratifikimin që i ka bërë Kuvendi i Shqipërisë Konventës-Kuadër për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare në vitin 1999.

Gjithsesi, megjithëse gjendja është përgjithësisht e kënaqshme, kjo nuk do të thotë se nuk ka patur probleme dhe se janë arritur të gjitha standartet e kërkuara si nga legjislacioni i brendshëm, ashtu edhe nga ai ndërkombëtar. Periudha e tranzicionit në Shqipëri ka qenë mjaft e vështirë dhe kjo ka kondicionuar si të drejtat e liritë themelore të shumicës së popullsisë, ashtu edhe ato të grupeve qeveritare.

Ka ende mjaft probleme që u duhet kushtuar më shumë vëmendje. Gjatë këtyre 23 vjetëve të fundit janë marrë masa në disa drejtime për përmirësimin e mëtejshëm të situatës. Janë bërë përpjekje në drejtim të përmirësimit të arsimit, të infrastrukturës, të intensifikimit të marrëdhënieve me Maqedoninë fqinje. Janë bërë studime për një funksionim më të mirë të shkollave, për shëndetsinë, për zhvillimin e ekonomisë dhe perspektivat e saj.

Banorët e zonës së Prespës merren kryesisht me bujqësi, blegtori dhe peshkim. Merren edhe me tregëti duke përfituar nga lidhjet që kanë krijuar me Maqedoninë. Por këta aksesorë të ekonomisë nuk sigurojnë në masën e duhur nevojat e popullsisë. Prodhimet bujqësore janë mjaft të ulëta. Por zona e Prespës ka vlera të mëdha turistike. Me vendim të Qeverisë Qëndrore ajo është shpallur Park Nacional. Aty ndodhen kisha të shekujve XII dhe XIII të ndërtuara brenda në shkëmb, nga më të rrallat në Ballkan dhe në Evropë. Ato kanë vlera të veçanta artistike edhe për shkak të afreskeve të pikturuara brenda në shkëmb. Duke marrë parasysh këto vlera, zona e Prespës ka tërhequr vëmendjen edhe nga jashtë vendit. Ajo ka hyrë në projektet e Bankës Botërore dhe të Qeverisë Federale Gjermane. Për këtë qëllim, po bëhen studime për zhvillimin e turizmit.

Takimet në vend

Ndër takimet që u bënë në vend me banorët, ata shfaqën pakënaqësi për gjendjen e infrastrukturës. Janë bërë përmirësime, por ato janë të pamjaftueshme. Rruga që lidh zonën me Korçën, është në një gjendje të keqe. Për këtë arsye aktualisht mbetet ende deri diku e mënjanuar pikërisht për shkak të nivelit të ulët të infrastrukturës. Mungon lidhja e rregullt telefonike. U shpreh shqetësim edhe për ndërprerjet e energjisë

elektrike dhe gjendjen e pasigurtë të furnizimit me ujë të pijshëm, që ka gjithashtu ndërprerje.

U vendosën kontakte dhe u organizuan takime të ndryshme me qëllim që të krijohet një tablo sa më e plotë mbi gjendjen aktuale të këtij minoriteti dhe të drejtat që ata gëzojnë. Grupi i vëzhgimit mori takim me përfaqësues të lartë të autoriteteve të qarkut të Korçës, me përfaqësues të qeverisjes vendore, me Zyrën e Zhvillimit pranë Prefekturës, me Drejtorinë e Arsimit, me gazetarë të medias elektronike dhe Radios lokale. Tema u trajtua edhe në një bisedë me përfaqësuesin e OSBE-së në këtë rreth.

Një vend të rëndësishëm në këtë mision vëzhgimi zunë takimet në vend, në zonën e minoritetit. Kështu u vendosën kontakte dhe u zhvilluan biseda me përfaqësues të Komunës së Liqenasit (qendër e zonës), përfaqësues të arsimit, shëndetësisë, policisë kufitare të kësaj komune. Një takim i veçantë u bë me përfaqësues të shoqatës "Organizata e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të maqedonasve në Shqipëri - Shoqëria Prespa". Anëtarët e misionit u takuan edhe me banorët vendas, burra gra, fëmijë në disa fshatra të komunës.

Nga këto takime e biseda nuk rezultoi që të ketë patur raste diskriminimi të bazuar në përkatësinë kombëtare dhe as raste të zbatimit të diferencuar të ligjit, të shkeljes së parimit kushtetues sipas të cilit shtetasit janë të barabartë përpara ligjit. Po ashtu nuk u vërejtën raste të intolerancës dhe ksenofobisë, shumica dhe pakica janë në marrëdhënie normale dhe paqësore. Nuk u bë fjalë për ndonjë tentativë për asimilimin e minoritetit maqedon.

Arsimimi dhe media

Një vëmendje të veçantë gjatë këtyre takimeve, iu kushtua problemeve të arsimit. Për mbledhjen e të dhënave u bënë kontakte me përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të Korçës, drejtorin e shkollës Liqenas, si edhe me kryetarin e Komunës Liqenas nëpërmjet të cilave u arrit të bëhet një tablo e përgjithshme, që jep një ide të plotë të gjendjes së arsimit në zonën e Prespës si dhe të vendit që zë minoriteti maqedonas në median lokale.

Në të 9 fshatrat e kësaj zone ka shkolla fillore ku mësimi bëhet në gjuhën amtare, maqedonisht. Në dy fshatrat më të mëdha, në Liqenas dhe në Goricën e Madhe ka shkolla 8-vjeçare ku 20% e lëndëve bëhen në gjuhën amtare. Në qendër të Komunës ka edhe një shkollë të mesme. Në këtë shkollë zhvillohet gjërisht si lëndë më vete edhe historia e popullit maqedonas. Të gjitha shkollat minoritare kanë lidhje binjakëzimi me shkolla homologe në Maqedoni. I gjithë personeli mësimor është vendas dhe me arsimin përkatës. Personeli mësimor është arsimuar në Elbasan, Korçë si dhe Maqedoni. Mesatarisht ka një mësues për 15-20 nxënës. Një fakt pozitiv që u vu në dukje është se nuk ka braktisje të shkollës nga fëmijët. Personeli

mësimor i nënshtrohet një trajnimi të vazhdueshëm, por u shpreh keqardhje që një pjesë e personelit pas kualifikimit ose ndryshojnë drejtim pune dhe kalojnë në një sektor tjetër ose, pasi largohen, nuk kthehen më në zonë.

Nxënësit që mbarojnë shkollën e mesme shkojnë për të vazhduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në atë të Shkupit apo të Manastirit. Ka patur raste që disa të kenë shkuar për studim edhe në vende të tjera të Evropës. Shumica e atyre që nuk vazhdojnë studimet e larta shkojnë për të punuar në Maqedoni.

Në Drejtorinë e Arsimit të Korçës na u dha tabloja e mëposhtme e gjendjes së arsimit në këtë zonë.

Në këtë zonë funksionon një shkollë e mesme e bashkuar në fshatin Liqenas, një shkollë 8 vjeçare në fshatin Goricë e Vogël dhe 6 shkolla fillore në fshatrat Diellas, Lajthizë, Zaroshkë, Goricë e Madhe, Kallamas dhe Gollomboq. Në këto shkolla mësojnë gjithsej 468 nxënës prej të cilëve 208 janë vajza. Funksionojnë edhe 8 kopshte me 193 fëmijë; Aty punojnë 11 edukatorë prej të cilëve 8 janë me arsim të mesëm pedagogjik dhe 3 me arsim të lartë (për parashkollor). Numrin më të madh të fëmijëve në këto kopshte e kanë Liqenasi me 45 fëmijë, Kallamasi me 37 fëmijë dhe Gorica e Madhe me 28 fëmijë. Në të gjitha shkollat e zonës punojnë gjithsej 44 mësues, prej të cilëve 9 në arsimin mesëm në Liqenas (të gjithë me arsim të lartë), 12 në arsim 8-vjeçar të shkollës së Liqenasit, prej të cilëve 7 janë me arsim të lartë pedagogjik dhe 5 me arsim të mesëm pedagogjik. Në shkollën 8-vjeçare të Goricës së Vogël ku mësojnë 153 nxënës japin mësim 13 mësues, prej të cilëve 11 janë me arsim të lartë pedagogjik dhe 2 me arsim të mesëm pedagogjik.

Materiali jep të dhëna edhe për shpërndarjen e shkollave fillore të zonës si vijon:

Diellas	27 nxënës	2 mësues	1 me arsim të mesëm 1 me arsim të lartë
Lajthizë	7 nxënës	2 mësues	1 me arsim të mesëm 1 me arsim të lartë
Zaroshkë	24 nxënës	2 mësues	1 me arsim të mesëm 1 me arsim të lartë
Goricë e Madhe	38 nxënës	2 mësues	1 me arsim të mesëm 1 me arsim të lartë
Kallamas	30 nxënës	2 mësues	1 me arsim të mesëm 1 me arsim të lartë
Gollomboq	10 nxënës	1 mësues	1 me arsim të mesëm

Vetëm në shkollën e mesme të Liqenasit mësojnë 154 nxënës, ndërsa në arsimin 8 vjeçar 179 nxënës.

Me këtë rast u shprehën njëkohësisht disa shqetësime dhe u bënë propozime. U kërkua që në Drejtorinë Arsimore të Korçës të ketë një inspektor arsimit për këtë zonë, i cili do të kishte si detyrë të vendoste kontakte dhe të koordinonte lidhjet me shkollat përkatëse në Maqedoni. U shpreh shqetësimi që në disa programe mungojnë libra në gjuhën maqedonase, për të cilat nuk jepen fondet e mjaftueshme. Problemi mund të zgjidhjet me një koordinim më të mirë të punës midis palës shqiptare dhe asaj maqedonase. Një tjetër problem i ngritur nga përfaqësuesit e Komunës së Liqenasit ishte mbingarkesa e nxënësve me programe paralele në gjuhën shqipe dhe në atë maqedonase. Lidhur me këtë u sugjerua që letërsia shqipe të bëhet në gjuhën shqipe, kurse ajo maqedonase në gjuhën maqedonase. Kjo do të shmangte paralelizmin dhe mbingarkesën e panevojshme.

Gjatë vëzhgimit përfaqësuesit e minoritetit maqedonasparaqitën disa të dhëna lidhur me vendin që zë minoriteti maqedonas në median lokale. Në përgjithësi gjendja paraqitet si vijon. Në Radion e Korçës jepen në gjuhën maqedone 30 minuta emision për ditë. Në këto emisione jepen lajme dhe këngë nga folklori maqedonas. U bë vërejtje se nuk ka fonde të mjaftueshme për të dhënë më shumë emisione në gjuhën maqedonase. Por në Drejtorinë e Arsimit mësuam se po bëhen përpjekje për të hapur një radio lokale në Liqenas, e cila të funksionojë në kohë të plotë. Po kështu edhe televizioni lokal ka transmetuar emisione të veçanta nga kjo zonë. Veç asaj, minoriteti maqedon ka gazetën e vet, e cila del periodikisht. Është për t'u vlerësuar fakti se popullsia është e lirë të ushtrojë të drejtat fetare. Në shumicën e fshatrave janë rinovuar ose ndërtuar kisha të reja ortodokse, fakt i cili u konstatua gjatë vëzhgimit. Një kishë e re mjaft e madhe është Kisha e Shën Mërisë, për ndërtimin e së cilës një ndihmë të konsiderueshme ka dhënë Kisha Ortodokse e Maqedonisë.

Shëndetësia

Shëndetsia paraqitet po ashtu në parametra pozitivë. Nga të dhënat e mbledhura nga konstatimet e bëra nga grupi vëzhgimor, dhe nga biseda me Kruetarin e Komunës Liqenas, rezulton se në qendër të Komunës Liqenas funksionon një qendër spitalore. Niveli i shërbimit mjekësor është relativisht i kënaqshëm. Personeli që punon në këtë sektor është i plotë. Në çdo fshat ka një mami dhe një infermier. Një numër grash lindin fëmijë në Korçë, të tjera në Liqenas, por një pjesë e grave lindin në ambiente shtëpiake. Për të gjithë këtë zonë ka dy mjekë. U theksua se duhen bërë më shumë përpjekje për të përmirësuar kushtet e dhomave të lindjes nëpër fshatra, në mënyrë që gratë të lindin pranë familjeve të tyre. Disa OJQ kanë dhënë një kontribut për asistencë të drejtëpërdrejtë teknike si edhe lidhur me sensibilizimin e grave për shëndetin e tyre dhe të fëmijëve.

Zhvillimi ekonomik dhe perspektivat

Grupi i vëzhgimit i kushtoi vëmendje politikës së ndjekur për zhvillimin e kësaj zone. Kjo është një çështje që u bisedua posaçërisht në përfaqësues të administratës së Qarkut të Korçës të organeve të qeverisjes vendore dhe të Komunës. U dhanë sigurime për një kujdes të veçantë që tregohet për zhvillimin e saj si në fazën aktuale ashtu edhe në perspektivë. Me vendim të Këshillit të Ministrave, Prespa është shpallur Park Kombëtar. Janë hartuar projekte të ndryshme, ndër të cilët u përmendën ai i ujit të pijshëm (Kallamas), i ujitjes, për përmirësimin e rrugëve. Nga shoqata dhe organizata të ndryshme kryesisht gjermane janë kryer studime për zhvillimin e turizmit në zonën e Prespës. Në vend u shfaqën pakënaqësi për gjendjen e infrastrukturës, pa përmirësimin e të cilës nuk mund të ketë zhvillim të turizmit.

Si pasojë, zona e Prespës mbetet një zonë deri në një farë mase e mënjanuar, gjë që ka lidhje pikërisht me gjendjen e infrastrukturës. Mungon lidhja e rregullt telefonike. Tre fshatra nuk kanë ende ujë të pijshëm. Në disa të tjerë ka ndërprerje të shpeshta dhe të gjata të energjisë elektrike. Papunësia është relativisht e lartë, ndonëse jo aq sa në pjesë të tjera të vendit. Projektet e lartpërmendura shpresohet se do të sjellin një përmirësim të gjendjes.

Lidhjet me administratën lokale

Grupi i vëzhgimit kërkoi sqarime edhe për lidhjet e administratës lokale me zonën e minoritetit. Kjo çështje u bisedua posaçërisht me përfaqësues të administratës së Qarkut të Korçës, të administratës lokale dhe të vetë Komunës së Prespës. U krijua përshtypja se kontaktet janë të rregullta e të vazhdueshme. U dhanë sigurime për një kujdes të veçantë që duhet të tregohet për përmirësimin e gjendjes, për zhvillimin e zonës si në fazën aktuale, ashtu edhe në perspektivë.

Ankesa dhe kërkesa

Nga kontakti me drejtues të organeve të policisë dhe të qeverisjes vendore u konstatua se kriminaliteti nuk përbën problem shqetësues. Gjendja paraqitet e qetë dhe normale, madje ajo është më e mirë se në pjesët e tjera të Qarkut të Korçës. Vetgjqësia nuk përbën po ashtu problem, nuk ka patur raste të kësaj natyre. Praktika e hakmarrjes nuk gjen vend në këtë zonë.

Gjatë vëzhgimit në terren nga kontaktet me individë të ndryshëm u krijua përshtypja se sundon një atmosferë paqësore në nivelin njerëzor. Askush nga të anketuarit nuk bëri fjalë për probleme personale, as për grindje qoftë me banorë vendas, qoftë më pjesëtarë të shumicës. U vunë në dukje probleme të përgjithshme, ato që shqetësojnë bashkësinë disa prej të cilave u përmendën më lart. Pyetjes se a e ndjejnë banorët e

këtushëm veten të barabartë me të tjerët, ata u përgjigjën se ndaj tyre nuk vënë re ndonjë dallim bazuar në përkatësinë kombëtare dhe as raste të zbatimit të diferencuar të ligjit kundrejt banorëve minoritarë.

Në vazhdim të kontakteve u shprehën shqetësime lidhur me disa çështje të tjera të jetës së përditshme. Një shqetësim i tillë ishte ai që ka të bëjë me doganën. Përfaqësues të Komunës së Liqenasit si edhe të organizatës “Shoqëria Prespa” bënë vërejtje se në radhët e doganës dhe të policisë kufitare ka një numër të ulët të elementit maqedon. U tha se, ndonëse ka kuadro të arsimuar dhe të kualifikuar që mund ta kryenin këtë detyrë, është vënë re tendenca për të punësuar persona të ardhur, pra jo minoritarë. Nga një sondazh që bëri grupi i vëzhgimit në biseda me persona përgjegjës të këtyre strukturave del se nga 60 punonjës të policisë kufitare, 10 janë minoritarë, (grupi I vëzhgimit, veç takimeve me përfaqësues të organeve të policisë, shkoi vetë në kufi dhe mori takim me forcat e policisë kufitare). Po ashtu në doganën e Prespës nga 9 punonjës vetëm 2 janë vendas. Lidhur me këtë u bë edhe ankesa se dogana ekzistuese e zonës nuk bën asnjë veprim çdoganimi. Përfaqësuesit e “Shoqërisë Prespa” e quajtën këtë si një qëndrim diskriminues që ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të zonës. Përgjegjësit e doganës e konfirmuan këtë fakt por theksuan se kjo doganë nuk ka infrastrukturën e duhur dhe bazën materiale të mjaftueshme për të kryer veprime çdoganimi, ndërsa banorët lëvizin lirisht në pikën doganore.

Një ankesë tjetër kishte të bënte me praninë e banorëve vendas në radhët e forcave të rendit. U kërkua që në radhët e policisë të ketë më shumë policë që i përkasin minoritetit maqedon. Megjithatë, lidhur me këtë duhet përmendur fakti se ligji përcakton disa rregulla e kritere për punësimin në organet e rendit.

Marrëdhëniet me Shtetin amë

Në zbatim të nenit 17 të Konventës-kuadër Shteti Shqiptar i është përmbajtur frymës së mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me Shtetin maqedonas. Kontaktet dhe lidhjet paqësore midis minoritetit maqedonas dhe Maqedonisë jo vetëm nuk janë penguar, por janë inkurajuar gjatë gjithë vijës së kufirit që ndan Shqipërinë nga Maqedonia. Këto marrëdhënie kanë marrë një hov të ri në kushtet aktuale. Vlen të theksohet se minoritarët, duke qenë në kufi me Shtetin amë, kanë marrë ndihma dhe kanë përfituar shume lehtësira. Kështu, psh minoritarët e zonës së Prespës marrin viza falas për të hyrë në Maqedoni; librat në gjuhën maqedonase shtypen në Maqedoni dhe u jepen nxënësve falas; të gjithë mësuesit e shkollave minoritare shkojnë disa herë në vit në Maqedoni për kualifikim falas.

Ditët e para të gushtit 2002 ndodhi një incident i padëshiruar që del jashtë kuadrit të regjimit të minoriteteve. Ministri i Brendshëm i Shkupit bëri një vizitë në zonën e Prespës pa vënë në dijeni autoritetet shqiptare. Ai zhvilloi takime dhe mbajti fjalime pa u penguar. Por ai i kaloi caqet kur u tha banorëve se do të merrnin shtetësinë maqedonase; do të merrnin po ashtu të drejtën elektorale e cila do t'u jepte mundësi atyre të marrin pjesë në zgjedhjet që do të zhvillohen në mes të shtatorit 2002, për parlamentin maqedonas. Kjo i kalonte caqet e një kujdesi të thjeshtë për minoritarët. Ai u interpretua si një gjest i nxituar dhe i frymëzuar nga disa qarqe nacionaliste ekstreme në Maqedoni. Komiteti Maqedonas i Helsinkit protestoi ndaj kësaj inisiative duke e quajtur si një manovër të ndërmarrë nga qarqet ekstremiste për efekte elektorale.

Megjithashtë, është për t'u çmuar fakti se autoritetet shqiptare reagues me maturi dhe incidenti nuk u bë shkak për ndonjë konflikt midis dy palëve. Qeveria shqiptare iu përgjigj kësaj me një vizitë të menjëhershme që bëri Ministri i Çështjeve Sociale në këtë zonë. Ai e quajti veprimin e Ministrisë të Brendshme të Shkupit si turizëm politik. Në kontaktet që pati qoftë me organet vendore, qoftë me banorë të zonës ai theksoi se zona e Prespës është një zonë prioritare për shkak të resursave të shumta natyrore. Për këtë qëllim ai rekomandoi një bashkëpunim më të mirë me organet lokale sidomos për sa u përket investimeve. Ai shtoi se një numër projektsh janë në proces dhe mund të materializohen në fillim të vitit të ardhshëm. Inisiativës së Ministrisë të Brendshme të Shkupit ai iu përgjigj duke thënë se problemet e minoriteteve nuk zgjidhen me nacionalizëm por me integrim.

Tryezë e numbullakët në qytetin e Korçës

Pas vëzhgimit që u krye në zonën e Prespës ku banon minoriteti maqedonas (raporti përkatës u është dërguar), Komiteti Shqiptar i Helsinkit në datën 04.10.2002 organizoi në qytetin e Korçës një tryezë të rrumbullakët për të paraqitur konkluzionet e këtij vëzhgimi. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore, si edhe të minoritetit maqedonas. Merrnin pjesë gjithashtu drejtues të organizatave joqeveritare, punonjës të medias elektronike dhe të shkruar, si edhe dy përfaqësues të Komitetit Maqedonas të Helsinkit të ftuar nga ana jonë.

Drejtorja Ekzekutive e KSHH-së, Znj. Vasilika Hysi në fjalën e saj u ndal në disa çështje kryesore që u konstatuan gjatë vëzhgimit në zonën e Prespës dhe pikërisht në ato që kishin të bënin me arsimimin në gjuhën amtare, si edhe me vështrimin e të drejtave të tyre të tyre në të gjitha fushat e tjera në përputhje me Konventën Kuadër të Kopenhagenit dhe Kushtetutës sonë. Në këtë drejtim u përmendën fakte dhe raste që tregojnë përmirësimet e arritura në këtë zonë në arsim, shëndetsi, kulturë dhe

infrastrukturë. Të metat dhe mungesat e evidentuara nuk ishin të karakterit diskriminues fakt ky i konfirmuar edhe nga disa pjesëmarrës të këtij komuniteti. Kështu p.sh. mungesa e disa teksteve në gjuhën amtare kishte të bënte me probleme teknike dhe të zbatimit të marrëveshjeve midis dy vendeve Shqipëri-Maqedoni. Megjithatë për këtë çështje është informuar Ministria e Arsimit e cila është angazhuar që kjo çështje të marrë rrugën e zgjidhjes. Veç kësaj, Drejtoria e Arsimit të Korçës mori përsipër që këtij problemi t'i kushtojë kujdes të veçantë.

Kryetari i shoqatës "Druzha Prespa" ngriti me forcë problemet që sipas tij preokupojnë këtë komunitet dhe që ai i konsideron si shenja diskriminimi.

Pikëpamjet e tij në këtë drejtim nuk gjetën mbështetje nga pjesëmarrësit e tjerë të cilët u shprehën dakord për përmirësimin e gjendjes dhe respektimin e të drejtave të këtij komuniteti, por nuk u pajtuan me mendimin e ekzistencës së ndonjë lloji diskriminimi.

Sidoqoftë, pjesëmarrësit në këtë takim arritën në përfundimin se jo vetëm nga organizatat joqeveritare dhe në mënyrë të veçantë nga KSHH, duhet të punohet më tepër për sensibilizimin e opinionit shoqëror lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve, por edhe organet e qeverisjes vendore duhet të tregojnë vëmendje të veçantë në problemet që preokupojnë komunitetet në Shqipëri.